<p>drejtave pronësore, qirave, fitoreve në lotari, përveç nëse janë paguar më apo para 31 marsit të periudhës tatimore vijuese. Çdo shpenzim që nuk lejohet me këtë paragraf është i zbritshëm në periudhën tatimore në të cilën në të vërtetë është paguar.</p> <p>4. Tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto prej tridhjetëmijë euro (30,000 €) e më shumë, dhe tatimpaguesit të cilët kanë zgjedhur të mbajnë libra dhe regjistrime siç kërkohet në nenin 34 të këtij ligji, mund të zbresin shpenzimet e lejuara e të paguara apo të akruara gjatë periudhës tatimore.</p> <p>5. Nuk lejohet zbritje për ndonjë shpenzim derisa nuk dokumentohet në mënyrën e kërkuar me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p> <p>6. Shpenzimet, përfshirë shpenzimet e zhvlerësimit, që lidhen me lizingjet operative dhe lizingjet financiare raportohen në mënyrën e përcaktuar me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p> <p>7. Ministri nxjerr akt nënligjor për shpenzimet e dokumentuara të cilat rrjedhin nga vlerësimet dhe rivlerësimet doganore.</p>	<p>etc.) unless it is paid on or before 31 March of the subsequent tax period. Any expense not allowed by this sub-paragraph shall be deductible in the tax period in which it is actually paid.</p> <p>4. Businesses with annual gross income of thirty thousand Euros (€30,000) and more, and those businesses which have opted to maintain books and records as required in Article 34 of this Law, may deduct the expenses that are allowed and paid or accrued during the tax period.</p> <p>5. No deduction shall be allowed for any expense unless documented in the way required by the sub-legal act issued by the Minister.</p> <p>6. Expenses, including the expenses of depreciation, regarding the operating and financial leasing shall be reported in the way stipulated in a sub-legal act to be issued by the Minister.</p> <p>7. The Minister issues sub-legal act for the documented expenses arising from customs assessments and re-assessments.</p>	<p>imovinskim pravima, zakupima, dobitku na lutriji, osim ako su plaćeni 31. marta ili pre narednog poreskog perioda. Svaki trošak koji nije dozvoljen prema ovom stavu odbija se u poreskom periodu u kojem je stvarno isplaćen.</p> <p>4. Poreski obveznici sa bruto godišnjim dohodakom od trideset hiljada evra (30,000 evra) i više i poreski obveznici koji su izabrali da vode knjige i evidencije u skladu sa članom 34. ovog zakona mogu odbiti dozvoljene i plaćene ili obračunate troškove tokom poreskog period.</p> <p>5. Nije dozvoljen odbitak za bilo koji trošak sve dok se ne dokumentuje na način koji zahteva podzakonski akt izdat od strane Ministra.</p> <p>6. Troškovi, obuhvatajućitroškove amortizacije, koji se odnose na operativni lizing i finansijski lizing, izveštavaju se na određen način podzakonskim aktom koji izdaje Ministar.</p> <p>7. Ministar donosi podzakonski akt za dokumentovane troškove koji proizilaze iz carinskih procena i ponovnog procenjivanja.</p>
---	---	--

<p align="center">Neni 17 Shpenzimet e përfaqësimit, reklamës dhe promocionit ekonomik</p>	<p align="center">Article 17 Expenses for Representation, advertisement and economic promotion</p>	<p align="center">Član 17 Troškovi zastupljanja, reklame i ekonomske promocije</p>
<p>1. Në shpenzimet e përfaqësimit përfshihen shpenzimet me karakter të përgjithshëm që një person afarist bënë për prezantimin dinjitoz të tij në marrëdhënie me partnerët apo institucionet e tjera, si: organizimi i takimeve, prezantimi i projekteve të reja, përirimi i linjave apo prodhimeve të reja, qerasjet dhe pritje-përcjelljet që lidhen me aktivitetin e biznesit.</p> <p>2. Shpenzimet e përfaqësimit janë të kufizuara në një përqind (1%) të të ardhurave bruto vjetore.</p> <p>3. Shpenzimet e reklamës dhe promocionit të cilat bëhen përmes formave të ndryshme të informimit, siç janë: televizioni, radio, gazeta, revista, reklama e drejtpërdrejtë, interneti, posterat, afishet, billboardat, reklammat tranzite e të tjera të ngjashme, janë shpenzime tërësisht të zbritshme për qëllime tatimore.</p>	<p>1. Representation expenses include costs of general character that a business person makes for his dignified presentation in relation to his partners or other institutions, such as organising meetings, presentation of new projects, and inauguration of new production lines, treats and receptions related to business activity.</p> <p>2. Representation costs will be limited to one percent (1%) of annual gross income.</p> <p>3. The costs of advertising and promotion which are made through different forms of media, such as television, radio, newspapers, magazines, direct advertising, the Internet, posters, placards, billboards, transit advertising and similar are fully deductible expenses for tax purposes.</p>	<p>1. Troškovi zastupanja obuhvaćaju troškove opšte prirode koje je privredno lice uradilo za svoje dostojanstveno predstavljanje u odnosima sa partnerima ili drugim institucijama kao što su: organizovanje sastanaka, predstavljanje novih projekata, inauguracija novih linija ili proizvoda, tretmani i aktivnosti vezane za posete i dočeke vezane za poslovnu delatnost.</p> <p>2. Troškovi zastupanja su ograničeni na jedan procenat (1%) bruto godišnjeg dohodaka.</p> <p>3. Troškovi reklama i promocije koji se rade kroz različite oblike informacija, kao što su televizija, radio, novine, časopisi, direktno oglašavanje, internet, poster, plakati, bilbordi, tranzitne reklame i drugo slično oglašavanje, u potpunosti su odbitak za poreske svrhe.</p>

<p align="center">Neni 18 Shpenzimet e Borxhit të keq</p>	<p align="center">Article 18 Bad Debt Expenses</p>	<p align="center">Član 18 Troškovi lošeg duga</p>
<p>1. Një borxh i keq konsiderohet shpenzim nëse i plotëson kushtet vijuese:</p> <p>1.1. pagesa nuk është marrë plotësisht apo pjesërisht dhe është shpallur si i pambledhshëm duke iniciuar procedurat në organet gjyqësore;</p> <p>1.2. borxhit i kanë kaluar së paku gjashtë muaj nga afati i obligimit për pagesë;</p> <p>1.3. shuma që korrespondon me borxhin, më herët është përfshirë në evidenca kontabël si e ardhur;</p> <p>1.4. nuk ka kontest mbi vlefshmërinë juridike të borxhit;</p> <p>1.5. ka evidencë të mjaftueshme se janë bërë përpjekje substanciale për të vjelë borxhin, përfshirë çdo veprim të aplikueshëm për të maksimalizuar mbledhjen e borxhit sikurse janë:</p> <p>1.5.1. tatimpaguesi ka balancuar çdo borxh të pakontestueshëm kundrejt borxhit të keq;</p>	<p>1. A bad debt shall be considered an expense if it meets the following conditions:</p> <p>1.1. payment is not fully or partly received and is declared as uncollectible by initiating judicial procedures;</p> <p>1.2. at least six months have exceeded from debt payment deadline;</p> <p>1.3. the amount that corresponds to the debt has previously been included in accounting registers as income;</p> <p>1.4. there is no dispute of the legal validity of the debt;</p> <p>1.5. there is sufficient evidence that substantial efforts were made to collect the debt, including any applicable actions to maximize collection of the debt, such as:</p> <p>1.5.1. taxpayer has offset (balanced) any undisputed debt owed to the debtor against the bad debt;</p>	<p>1. Loš dug se smatra troškom ako ispunjava sledeće uslove:</p> <p>1.1. isplata nije u potpunosti ili delimično primljena i proglašena je neisplativom pokretanjem postupka u sudskim organima;</p> <p>1.2. dugu je prošlo najmanje šest meseci od roka obaveze za isplatu;</p> <p>1.3. iznos koji odgovara dugu je ranije uključen u računovodstvene dokaze kao dohodak;</p> <p>1.4. nije sporno o pravnoj valjanosti duga;</p> <p>1.5. postoje dovoljni dokazi da su učinjeni znatni naponi za povraćaj duga, obuhvatajućii bilo kakvu akciju za povećanje naplate dugova kao što su:</p> <p>1.5.1. poreski obveznik je balansirao svaki nesporni dug naspram lošeg duga;</p>

<p>1.5.2. korrespondenca dhe kontaktet në përpjekje për të vjelë borxhin;</p> <p>1.5.3. kërkesa është dorëzuar mbi mjetet e falimentimit/likuidimit, nëse është e aplikueshme dhe shuma që merret është përcaktuar në mënyrë të arsyeshme nga administratori/përmbaruesi, si dhe deri në shkallën sa janë marrë nga falimentimi, janë aplikuar në borxhin e pashlyer.</p> <p>1.6. tatimpaguesi lëshon një faturë për shumën e paarkëtuar ku shkruhen fjalët “Borxh i keq”, si dhe numri i faturës me të cilën lidhet ky borxh, faturë, e cila i shërben shitësit për të zvogëluar të ardhurën dhe blerësit për të zvogëluar shpenzimin (koston);</p> <p>1.7. për shumën deri në pesëqind (500) euro, të trajtuar si borxh i keq, nuk kërkohet inicimi i procedurave gjyqësore.</p> <p>2. Zbritjet e borxhit të keq janë të kufizuara në pjesën e pambuluar të borxhit. Çdo borxh i keq i zbritur si një shpenzim që pastaj është mbledhur, përfshihet në të ardhurat e tatimpaguesit në periudhën e mbledhjes.</p>	<p>1.5.2. correspondence and contacts attempting to collect the debt;</p> <p>1.5.3. a claim was filed on a bankruptcy/liquidation proceeding, if applicable, and the amount that will be taken is determined in a reasonable way by the administrator/executor to the extent deriving from the bankruptcy are applied in the unsettled debt.</p> <p>1.6. the taxpayer must issue a receipt for the uncollected amount writing down the words “bad debt” as well as invoice number, linked to this debt, an invoice which serves the vendor to deduct income and purchaser to deduct spending(cost).</p> <p>1.7 for the amount up to five hundred Euros(€500) treated as bad debt, no judicial procedures are required to be initiated.</p> <p>2. Bad debt deductions are limited to the nonrecovered portion of the debt. Any bad debt deducted as an expense and then subsequently collected shall be included in income at the time of collection.</p>	<p>1.5.2. korespondencija i kontakti u pokušaju da se vrati dug;</p> <p>1.5.3. zahtev je podnet o stečaju / likvidacijskom pravnom leku, ukoliko je primenjivo, a primljeni iznos je opravdano izračunat od administratora / izvršioca, a stepen stečaja primenjen je na neplaćeni dug.</p> <p>1.6. poreski obveznik izdaje fakturu za nenaplaćeni iznos u kome su napisane reči "loš dug", kao i broj fakture sa kojim je povezan ovaj dug, faktura, koja služi prodavcu da smanji dohodak i kupcu da snizi trošak (trošak);</p> <p>1.7. za iznos do petsto (500) evra, tretiran kao loš dug, nije potrebno pokretanje sudskog postupka.</p> <p>2. Odbitak od lošeg duga ograničen je na deo nepokrivenog duga. Svaki loši dug koji se odbije kao trošak koji se potom prikuplja, je uključen u dohodak poreskog obveznika tokom perioda naplate.</p>
--	--	--

<p>3. Shuma e paarkëtuar nuk konsiderohet borxh i keq nëse:</p> <p>3.1. transaksionet me të njëjtin borxhli janë përsëritur pas shpalljes së borxhit të keq, me përjashtim të shërbimeve publike;</p> <p>3.2. borxhi i keq është ndërmjet palëve të lidhura;</p> <p>3.3. nuk ka evidencë të mjaftueshme se janë bërë përpjekje substanciale për të mbledhur borxhin, përfshirë çdo veprim të aplikueshëm për të maksimalizuar mbledhjen e borxhit;</p> <p>3.4. procedurat për ta shpallur borxh të keq nuk janë iniciuar brenda 24 muajve nga data e obligimit për pagesë.</p> <p>4. Ministri nxjerr akt nënligjor për të përshkruar kërkesat për zbritjen e borxhit të keq sikur që është paraparë me këtë nen.</p>	<p>3. The amount shall not be deemed as uncollectable bad debt if:</p> <p>3.1. transactions with the same debtor are repeated after the bad debt is declared; excluding the public services;</p> <p>3.2. bad debt is between related parties;</p> <p>3.3. there is no sufficient evidence that substantial efforts were made to collect the debt, including any applicable actions to maximize collection of the debt;</p> <p>3.4. the procedures for declaring bad debt were not initiated within 24 months from the date of payment obligation.</p> <p>4. The Minister shall issue a sub-legal act to describe the requirements for bad debt deductions as foreseen in this article.</p>	<p>3. Nenaplaçeni iznos se ne smatra lošim dugom ako:</p> <p>3.1. transakcije sa istim dužnikom ponovljene su nakon objavljivanja lošeg duga, sa izuzetkom javnih usluga;</p> <p>3.2. loš dug je između povezanih strana;</p> <p>3.3. nema dovoljno dokaza da su učinjeni znatni naponi za prikupljanje duga, obuhvatajućibilo kakvu akciju za maksimalno prikupljanje duga;</p> <p>3.4. procedure za proglašavanje lošeg duga nisu pokrenute o toku 24 meseca od dana obaveze za plaćanje.</p> <p>4. Ministar donosi podzakonski akt koji opisuje uslove za umanjenje lošeg duga kako je predviđeno ovim članom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 19 Shpenzimet afariste të udhëtimit</p> <p>1. Shpenzimet afariste të udhëtimit përfshijnë transportimin, shpenzimet e llojllojshme të udhëtimit për të punësuarin, siç janë: shpenzimet ditore, akomodimi</p>	<p style="text-align: center;">Article 19 Business Travel Expenses</p> <p>1. Business travel expenses include transportation, different travel expenses for the employee such as: daily expenses, accommodation and meals for business trip</p>	<p style="text-align: center;">Član 19. Poslovni troškovi putovanja</p> <p>1. Troškovi službenih putovanja obuhvaćaju prevoz, razne putne troškove zaposlenog, kao što su: dnevni troškovi, smeštaj i obroci za poslovna putovanja, ali</p>

<p>dhe shujtat për udhëtime afariste, por nuk përfshijnë kompensimin për vajtje-ardhje në vendin e punës.</p> <p>2. Shpenzimet për udhëtim, shujta, akomodim, dhe shpërngulja kufizohen në shumat që saktësohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p>	<p>but do not include allowances for commuting to and from the place of work.</p> <p>2. Expenses for travel, meals, accommodation, and moving out shall be limited to the amounts to be specified in a sub-legal act to be issued by the Minister.</p>	<p>ne obuhvaćaju putnu naknadu dolazak - odlazak na radno mesto.</p> <p>2. Troškovi putovanja, obroci, smeštaj i raseljavanja su ograničeni na iznose utvrđene podzakonskim aktom koje izdaje Ministar.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 20 Pagesat për personat e lidhur</p> <p>1. Kompensimi ose pagat e paguara për personin e lidhur lejohen si shpenzime në shumën e barabartë me vlerën e hapur të tregut.</p> <p>2. Interesi, qiraja dhe shpenzimet tjera që i paguhen personave të lidhur lejohen si shpenzime në shumën e barabartë me vlerën e hapur të tregut.</p>	<p style="text-align: center;">Article 20 Payments to Related Persons</p> <p>1. Remunerations or wages paid to a related person shall be allowed as an expense in an amount equal to the open market value.</p> <p>2. Interest, rent, and other expenses paid to a related person shall be allowed as an expense in an amount equal to the open market value.</p>	<p style="text-align: center;">Član 20 Isplate za povezanih lica</p> <p>1. Naknada ili plate koje se isplaćuju povezanim licima dozvoljene su kao troškovi u iznosu jednakoј vrednosti otvorenog tržišta.</p> <p>2. Kamata, renta i ostali troškovi koji se plaćaju povezanim licima dozvoljeni su kao troškovi u iznosu jednakoј vrednosti otvorenog tržišta.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 21 Zhvlerësimi</p> <p>1. Shpenzimet për pronën e prekshme, përveç shpenzimeve për tokën, veprat artistike dhe pronën tjetër e cila nuk konsumohet që i posedon tatimpaguesi dhe që shfrytëzohet për aktivitete ekonomike të tatimpaguesit, kompensohen me kalimin</p>	<p style="text-align: center;">Article 21 Depreciation</p> <p>1. Expenditures on tangible property, other than expenditures for land, works of art, and other property which are not subject to wear out, owned by the taxpayer and used for the taxpayer's economic activity, shall be recovered over time by depreciation</p>	<p style="text-align: center;">Član 21 Amortizacija</p> <p>1. Troškovi materijalne imovine, osim troškova vezanih za zemljište, umetničkih dela i drugih stvari koje poreski obveznik ne troši i koristi se za ekonomske aktivnosti poreskog obveznika, nadoknađuju se</p>

<p>e kohës përmes zbritjeve të zhvlerësimit në mënyrën e përcaktuar me këtë nen.</p> <p>2. Shpenzimet për përmirësimin e pronave me qira të cilat përdoren për aktivitete ekonomike të tatimpaguesit, kompensohen përmes zbritjeve të zhvlerësimit të llogaritura me metodën lineare për periudhën e kohëzgjatjes së qirasë.</p> <p>3. E gjithë prona e prekshme e tatimpaguesit që i nënshtrohet zhvlerësimit sipas këtij neni, caktohet në njërën prej kategorive vijuese:</p> <p>3.1. Kategoria 1 - Ndërtesat dhe strukturat tjera ndërtimore;</p> <p>3.2. Kategoria 2 - Automobilot dhe kamionët e lehtë, mjetet e rënda për transport, pajisjet për bartje të dheut, buldozerët, gërmuesit e dheut dhe mjetet tjera të rënda, kompjuterët, pjesët shtesë për kompjuterë dhe pajisjet tjera për përpunimin e të dhënave, mobiliet dhe pajisjet për zyra, instrumentet, gjërat e ndryshme dhe pajisjet tjera shtesë, dhe bagëtitë të shfrytëzuara për prodhim ose për mbarështim;</p> <p>3.3. Kategoria 3 - Uzinat dhe makineria; inventari i hekurudhës dhe lokomotivat</p>	<p>deductions in the manner prescribed by the present Article.</p> <p>2. Expenditures on improvements to leaseholds used for the taxpayer's economic activity shall be recovered through depreciation deductions calculated using the straight-line method with a period equal to the duration of the leasehold.</p> <p>3. All tangible property of the taxpayer that is subject to depreciation under this Article shall be placed in one of the following categories:</p> <p>3.1. Category 1- Buildings and other construction structures;</p> <p>3.2. Category 2 - Automobiles and light trucks, heavy transport vehicles, dirt moving equipment, bulldozers, scrapers and other heavy vehicles, computers, peripherals and other data processing equipment, office furniture and equipment, instruments, sundries and other accessories; and livestock used for production or breeding;</p> <p>3.3. Category 3 - Plant and machinery; railway inventory and locomotives used</p>	<p>vremenom putem amortizacije na način utvrđen ovim članom.</p> <p>2. Rashodi za poboljšanje imovine pod zakupom koja se koristi za ekonomske aktivnosti poreskog obveznika, nadoknađuju se s odbitkom amortizacije izračunatom linearnom metodom za period trajanja zakupa.</p> <p>3. Sva materijalna imovina poreskog obveznika koja podležu amortizaciji prema ovom članu, određuje se u jednoj od sledećih kategorija:</p> <p>3.1. Kategorija 1 - Zgrade i druge građevinske strukture;</p> <p>3.2. Kategorija 2 - Vozila i laki kamioni, teška transportna vozila, oprema za transport zemlje, buldožeri, bageri i druga teška oprema, računari, dodatni računarski delovi i druga oprema za obradu podataka, kancelarijski nameštaj i uređaji, instrumenti, razne stvari i druga oprema, i stoka koja se koristi za proizvodnju ili uzgoj;</p> <p>3.3. Kategorija 3 - Fabrike i mašine; železnički inventar i lokomotive koje</p>
---	--	--

<p>që shfrytëzohen për transportin hekurudhor; aeroplanët; anijet dhe bimët shumë vjeçare dhe shkurret e shfrytëzuara për vreshtari ose për prodhimin e frutave; dhe të gjitha asetet e prekshme që nuk janë përfshirë në kategorinë 1 apo kategorinë 2 të këtij paragrafi.</p>	<p>for rail transport; airplanes; ships; perennial plants and trees used for viniculture or production of fruits ; and all other tangible assets not included in Category 1 or Category 2 of this paragraph.</p>	<p>se koriste za železnički saobraćaj; avioni; brodovi i višegodišnje biljke i grmlje koje se koristi za vinograd ili proizvodnju voća; i sva materijalna sredstva koja nisu obuhvaćena u kategoriju 1 ili kategoriju 2 ovog stava.</p>
<p>4. Shuma e lejuar si zbritje për zhvlerësim në periudhën tatimore përcaktohet duke aplikuar përqindjet e mëposhtme në mënyrë individuale të pronës së prekshme individuale, sipas metodës lineare në fund të periudhës tatimore, sipas kategorisë së cilës i përkasin asetet:</p>	<p>4. The amount allowed as a depreciation deduction for the tax period shall be determined by applying the following percentages individually to the individual tangible property under the straight-line method at closing of the tax period according to the category where the asset belongs:</p>	<p>4. Dozvoljeni iznos kao odbitak za amortizaciju u poreskom periodu određuje se primenom sledećih procenata pojedinačno na pojedinačnu materijalnu imovinu, prema linearnoj metodi na kraju poreskog perioda, prema kategoriji kojoj pripada imovina:</p>
<p>4.1. Kategoria 1 - pesë për qind (5%);</p> <p>4.2. Kategoria 2 - njëzet për qind (20%) dhe</p> <p>4.3. Kategoria 3 - dhjetë për qind (10%).</p>	<p>4.1. Category 1 - five percent (5%);</p> <p>4.2. Category 2 - twenty percent (20%); and</p> <p>4.3. Category 3: ten percent (10%).</p>	<p>4.1. Kategorija 1 – pet procenata (5%)</p> <p>4.2. Kategorija 2 - dvadeset procenata (20%) i</p> <p>4.3. Kategorija 3 – deset procenata (10%)</p>
<p>5. Një pasuri për aspekte zhvlerësimi merret parasysh kur vihet për herë të parë në përdorim.</p>	<p>5. For depreciation purposes, an asset shall first be taken into account when it is firstly put in place/service.</p>	<p>5. Imovina u pogledu amortizacije uzima se u obzir prilikom stavljanja po prvi put u upotrebu.</p>
<p>6. Shuma fillestare që zhvlerësohet është çmimi i blerjes apo, në mungesë të çmimit</p>	<p>6. The initial amount to be depreciated shall be the purchase price or, in absence of</p>	<p>6. Početni iznos koji se amortizuje je nabavna cena ili, u nedostatku kupovne</p>

<p>të blerjes, çmimi i kostos. Shuma fillestare përfshinë:</p> <p>6.1. detyrimet tatimore, ngarkesat, taksat dhe kamatat që i ngarkohen kësaj pasurie para se të vihet në shërbim pasuria;</p> <p>6.2. shpenzimet e rastit sikurse janë provizioni, paketimi, transporti dhe shpenzimet e sigurimit të ngarkuara nga furnizuesi.</p> <p>7. Blerja e një pasurie për çmimin deri në një mijë euro (1,000 €) lejohet si shpenzim rrjedhës, me përjashtim kur pasuria funksionon si pjesë e një tërësie, dhe vlera e tërësisë kalon mbi një mijë euro (1,000 €) dhe afati i jetëgjatësisë është mbi një (1) vit.</p>	<p>a purchase price, the cost price. The initial amount shall also include:</p> <p>6.1. taxes, duties, levies and interest charged to this asset before it is put into service;</p> <p>6.2. Incidental expenses such as commission, packing, transport, and insurance costs charged by the supplier.</p> <p>7. The purchase of a property for a price up to one thousand Euros (€1,000) shall be allowed as a current expense with an exception when the asset functions as a part of whole and the value of whole exceeds one thousand Euros (€1,000).and the deadline is over one (1) year.</p>	<p>cene, cena koštanja. Početni iznos obuhvata:</p> <p>6.1. poreske obaveze, naknade, porezi i kamate koji se naplaćuju ovoj imovini pre nego što se imovina pusti u upotrebu;</p> <p>6.2. povremeni troškovi kao što su troškovi nabavke, pakovanja, transporta i osiguranja koje naplaćuje dobavljač.</p> <p>7. Kupovina imovine po ceni do hiljadu eura (€ 1,000) dozvoljeno je kao odliv gotovine, osim ako sredstvo funkcioniše kao deo jeden celine, a ukupna vrednost prelazi hiljadu eura (1,000€) i roka o životnoj dugovečnosti je preko jedne (1) god.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 22 Zhvlerësimi i aktiveve biologjike</p> <p>1. Zhvlerësimi i aktiveve biologjike është i lejuar vetëm nëse janë përdorë gjatë rrjedhës së veprimtarisë ekonomike.</p> <p>2. Zhvlerësimi i aktiveve biologjike siç është referuar në paragrafin 1 të këtij neni, specifikohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.</p>	<p style="text-align: center;">Article 22 Depreciation of biological activities</p> <p>1. Depreciation of biological activities is allowed only if they are used in the course of economic activity.</p> <p>2. Depreciation of biological as referred to in paragraph 1 of this Article shall be specified under a special sub-legal act issued by the Minister.</p>	<p style="text-align: center;">Član 22 Amortizacija bioloških aktivnosti</p> <p>1. Amortizacija biološke imovine dozvoljena je samo ako se koristi u toku ekonomske aktivnosti.</p> <p>2. Amortizacija biološke imovine iz stava 1. ovog člana određuje se podzakonskim aktom koji izdaje Ministar.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 23 Zbritjet e posaçme për pasuritë e reja</p>	<p style="text-align: center;">Article 23 Special Deductions for New Assets</p>	<p style="text-align: center;">Član 23 Posebni odbici za nove imovinu</p>
<p>1. Nëse një tatimpagues blen linjat prodhuese për uzina dhe makineri, inventari i hekurudhës dhe lokomotivat që shfrytëzohen për transportin hekurudhor, aeroplanë, anijet, mjetet e rënda për transport, pajisjet për bartje të dheut, buldozerët, gërmuesit e dheut dhe mjetet tjera të rënda për qëllimet e veprimtarisë ekonomike të tatimpaguesit, lejohet një zbritje e veçantë prej dhjetë për qind (10%) të çmimit të përvetësimit të pasurisë, në vitin në të cilin pasuria është vënë për herë të parë në shërbim.</p> <p>2. Përveç zbritjes normale të zhvlerësimit të lejueshëm, lejohet zbritja prej dhjetë për qind (10%) e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni.</p> <p>3. Zbritja lejohet vetëm nëse pasuria është e re ose është vënë për herë të parë në përdorim në Kosovë. Zbritja nuk lejohet nëse pasuria është bartur nga një biznes ekzistues ose një biznes i mëparshëm në Kosovë apo jashtë Kosovës.</p> <p>4. Zbritjet tjera të posaçme mund të jepen vetëm nëse parashihen me ligj të veçantë.</p>	<p>1. If a taxpayer purchases production lines for plant and machinery, railway inventory and locomotives used for railway transportation, airplanes, ships, heavy transport vehicles, earth moving equipment, bulldozers, scrapers and other heavy vehicles for the purpose of the taxpayer's economic activity, a special deduction of ten percent (10%) of the asset acquisition price shall be deducted in the year when the asset has been first put into service.</p> <p>2. The deduction from ten percent (10%) as foreseen with the paragraph 1 of this article shall be made in addition to the normal allowable depreciation deduction.</p> <p>3. The deduction shall be allowed only if the asset is new or is put into service in Kosovo for the first time. A deduction shall not be allowed if the asset is transferred from an existing or a former business in Kosovo, or outside of Kosovo.</p> <p>4. Other special deductions may only be granted if provided so by specific law.</p>	<p>1. Ako poreski obveznik kupi proizvodne linije za pogone i strojeve, inventar železnice i lokomotive koji se koriste za železnički saobraćaj, avione, brodove, teška transportna vozila, opremu za transport zemljišta, buldožere, bagere i ostali teški alati za svrhe ekonomske aktivnosti poreskog obveznika, dozvoljen je poseban odbitak od deset procenata (10%) cene prisvajanja imovine, u godini kada je imovina prvobitno stavljena u promet.</p> <p>2. Osim normalnog odbitka dozvoljene amortizacije, dozvoljen je odbitak od deset procenata (10%) predviđen u stavu 1 ovog člana.</p> <p>3. Odbitak je dozvoljen samo ako je imovina nova ili se stavlja po prvi put u upotrebu na Kosovu. Odbitak nije dozvoljen ako se sredstvo prenese sa postojećeg posla ili prethodnog posla na Kosovu ili van Kosova.</p> <p>4. Ostali posebni odbici mogu se odobriti samo ako je predviđeno posebnim zakonom.</p>

<p>5. Zbritja sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk lejohet për personat të cilët përfitojnë sipas nenit 9, paragrafit 1.27 të këtij ligji.</p>	<p>5. The deduction under paragraph 1 of this Article shall not be permitted for persons benefiting under Article 9, paragraph 1.27 of this Law.</p>	<p>5. Odbitak iz stava 1. ovog člana nije dozvoljen za lica koja imaju koristi iz člana 9. ovog zakona predviđenog u stavu 1.27</p>
<p style="text-align: center;">Neni 24 Riparimet dhe përmirësimet</p>	<p style="text-align: center;">Article 24 Repairs and Improvements</p>	<p style="text-align: center;">Član 24 Renoviranja i i popravke</p>
<p>1. Në rast të ndonjë aseti të zhvlerësueshëm, shumat e shpenzuara për riparime apo për përmirësimet, përjashtuar riparimet e mirëmbajtjes së zakonshme, kapitalizohen dhe shtohen në bazën e asetit nëse riparimet apo përmirësimet tejkalojnë jetën e përdorimit të asetit për së paku një vit dhe shuma e riparimit apo përmirësimit është më e madhe se njëmijë euro (1,000€) për atë aset. Nëse riparimi apo përmirësimi është njëmijë euro (1,000 €) apo më pak për ndonjë aset, shuma e riparimit apo përmirësimit është shpenzim në vitin që është paguar apo ka ndodhur.</p>	<p>1. In case of any depreciable asset, amounts spent for repairs or improvements, excluding repairs of usual maintenance, shall be capitalized and added to the basis of the asset if the repairs or improvements extend lifespan of the asset for at least one year and the amount of repair or improvement is bigger than one thousand Euro (€1,000) for that asset. If the repair or improvement is one thousand Euros (€1,000) or less for any asset, the amount of the repair or improvement shall be an expense in the year that it has been paid or occurred.</p>	<p>1. U slučaju bilo kakvog amortizovanog sredstva, iznosi utrošeni za renoviranja ili popravke, isključujući redovne popravke održavanja, kapitalizuju se i dodaju u osnovicu sredstava ako renoviranja ili popravke premašuju životni vek sredstva za najmanje godinu dana i iznos popravke ili poboljšanja je veći od hiljadu eura (€ 1,000) za to sredstvo. Ako je popravka ili poboljšanje hiljadu evra (1.000 evra) ili manje za bilo koju imovinu, iznos renoviranja ili popravke je trošak u godini kada je bila plaćena ili nastala.</p>
<p>2. Nëse riparimet apo përmirësimet plotësojnë kriterin për kapitalizim sipas paragrafit 1 të këtij neni, shuma kapitalizohet dhe shtohet në vlerën kontabël të mbetur të asetit kapital. Vlera e re kontabël e asetit përdoret si bazë për zhvlerësimin e asetit. Aseti zhvlerësohet në përputhje me rregullat e kategorisë së aplikueshme.</p>	<p>2. If the repairs or improvements meet the criteria for capitalization according to paragraph 1 of this Article, the amount shall be capitalized and added to the remaining accounting value of the capital asset. The new accounting value of the asset will be used as the basis for depreciating the asset. The asset will be depreciated in accordance with the rules of the applicable category.</p>	<p>2. Ako renoviranja ili popravke ispunjavaju kriterijum kapitalizacije iz stava 1 ovog člana, iznos se kapitalizuje i dodaje knjigovodstvenoj vrednosti kapitalne imovine. Nova knjigovodstvena vrednost sredstva se koristi kao osnova za umanjenje vrednosti imovine. Sredstva se amortizuju u skladu sa pravilima kategorije koja se primenjuje.</p>

<p>3. Ministri nxjerr akt nënligjor për zbatimin e këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 25 Amortizimi</p> <p>1. Shpenzimet në mjetet e paprekshme të cilat kanë afat të kufizuar përdorimi, përfshirë por duke mos u kufizuar në patentat, të drejtat e autorit, licencat për vizatime apo modele, kontratat dhe të drejtat ekskluzive, zbriten në formë të detyrimeve të amortizimit.</p> <p>2. Metoda e amortizimit është metoda e shlyerjes lineare dhe lejimi bazohet në afatin e përdorimit të pasurisë të përcaktuar në marrëveshjen ligjore mbi përvetësimin dhe përdorimin e pasurisë së paprekshme.</p> <p>3. Në rastet kur afati i përdorimit nuk është përcaktuar me marrëveshje, shpenzimet e amortizimit lejohen deri në njëzet (20) vite.</p>	<p>3. Minister shall issue a sub-legal act for implementation of this article.</p> <p style="text-align: center;">Article 25 Amortization</p> <p>1. Expenditures on intangible assets having a limited lifespan including, but not limited to patents, copyrights, licenses for drawings and models, contracts and exclusive rights are deductible in the form of amortization charges.</p> <p>2. The method of amortization shall be the straight-line settling method and the allowance shall be based on the lifespan of the asset as determined by the legal agreement governing the acquisition and use of the intangible asset.</p> <p>3. In cases when the term of use is not defined by an agreement, amortization expenses are allowed up to twenty (20) years.</p>	<p>3. Ministar donosi podzakonski akt za sprovođenje ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">Član 25. Amortizacija</p> <p>1. Troškovi nematerijalnih sredstava koja imaju ograničenu upotrebu, obuhvatajućiali ne ograničavajući se na patente, autorska prava, licence za crtanje ili dizajn, ugovore i franšize, odbijaju se u vidu amortizacije.</p> <p>2. Metoda amortizacije je metod linearnog poravnanja, a naknada se zasniva na trajanju korišćenja imovine utvrđene u zakonskom ugovoru o sticanju i korišćenju nematerijalnih sredstava.</p> <p>3. U slučajevima kada rok upotrebe nije određen sporazumom, troškovi amortizacije dozvoljeni su do dvadeset (20) godina.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 26 Shpenzimet kërkimore dhe zhvillimore</p> <p>1. Shpenzimet për kërkim dhe zhvillim lidhur me rezervat natyrore të mineraleve</p>	<p style="text-align: center;">Article 26 Research and Development Costs</p> <p>1. All research and development costs in respect of the natural reserves of minerals</p>	<p style="text-align: center;">Član 26. Troškovi istraživanja i razvoja</p> <p>1. Troškovi istraživanja i razvoja koji se odnose na prirodne rezerve minerala i</p>

<p>dhe të resurseve të tjera natyrore, si dhe kamatat që u ngarkohen, i shtohen llogarisë kapitale dhe amortizohen sipas këtij neni.</p> <p>2. Shuma e lejuar si zbritje për amortizim përkitazi me shpenzimet kërkimore dhe zhvillimore, e cekur në paragrafin 1 të këtij neni për periudhën tatimore, përcaktohet duke shumëzuar bilancin në llogarinë kapitale me një thyesë prej:</p> <p>2.1. numëruesi i së cilës paraqet njësitë e nxjerra prej rezervave natyrore gjatë vitit; dhe</p> <p>2.2. emëruesi i së cilës paraqet shumën e njësive të përgjithshme të parapara për t'u nxjerrë nga rezervat natyrore gjatë jetëgjatësisë së pasurisë.</p> <p>3. Njësitë e përgjithshme të parapara për nxjerrje, të referuara në paragrafin 2 të këtij neni përcaktohen në përputhje me udhëzimet lidhur me vlerësimet e tilla që vendosen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p>	<p>and other natural resources and interest attributable thereto shall be added to a capital account and amortized under the present Article.</p> <p>2. The amount allowed as an amortization deduction with respect to the research and development costs referred to in paragraph 1 of this Article for the tax period shall be determined by multiplying the balance in the capital account by a fraction of:</p> <p>2.1. whose numerator are the units extracted from the natural reserves during the year; and</p> <p>2.2. whose denominator presents the total amount of units to be extracted from the natural deposit over the lifespan of the asset.</p> <p>3. The estimated total units to be extracted referred to in paragraph 2 of this Article shall be determined in accordance with instructions concerning such estimates to be set out in a sub-legal act issued by the Minister.</p>	<p>drugih prirodnih resursa, kao i utvrđene kamate, dodaju se na kapitalni račun i amortizuju u skladu sa ovim članom.</p> <p>2. Iznos koji se dozvoljava kao odbitak za amortizaciju u pogledu troškova istraživanja i razvoja iz stava 1 ovog člana za poreski period, utvrđuje se pomnoživanjem stanja na kapitalnom računu sa frakcijom od:</p> <p>2.1. čiji brojilac predstavlja jedinice izvučene iz prirodnih rezervi tokom godine; i</p> <p>2.2. čiji imenitelj predstavlja iznos ukupnih jedinica predviđenih za odbitak od prirodnih rezervi za vreme trajanja imovine.</p> <p>3. Opšte jedinice predviđene za ekstruziju iz stava 2. ovog člana utvrđuju se u skladu sa uputstvima koja se odnose na procene koje mogu biti utvrđene podzakonskim aktom koji je izdao Ministar.</p>
--	---	--

<p align="center">Neni 27 Humbjet tatimore</p>	<p align="center">Article 27 Tax Losses</p>	<p align="center">Član 27 Poreski gubici</p>
<p>1. Humbje tatimore është ndryshimi negativ ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të lejuara, të përcaktuara me këtë ligj.</p> <p>2. Shuma e humbjes tatimore e përcaktuar sipas këtij neni bartet deri në katër (4) vite të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite.</p> <p>3. Shuma e bartur që merret parasysh për çfarëdo periudhe tatimore pas vitit të humbjes tatimore, është shuma e përgjithshme e humbjes e zvogëluar për shumën e grumbulluar që është lejuar më parë si zbritje.</p> <p>4. Nëse tatimpaguesi ka pasur humbje tatimore më gjatë se një (1) vit, ky nen zbatohet për humbjet që janë krijuar sipas radhës.</p> <p>5. Dispozitat e këtij neni janë të lejueshme vetëm për tatimpaguesin i cili ka krijuar humbjen. Nëse biznesi ka ndryshim në pronësi prej më shumë se pesëdhjetë përqind (50%) apo nëse një ndërmarrje personale afariste është ndryshuar në</p>	<p>1. A tax loss is the negative difference between the income and allowed expenses determined with this law.</p> <p>2. The amount of the tax loss determined under the present Article may be carried forward for up to four (4) successive tax periods and shall be available as a deduction towards any income in those years.</p> <p>3. The carried forward amount taken into account for any tax period after the year of the tax loss shall be the entire amount of the loss, reduced for the aggregate amount previously allowed as a deduction.</p> <p>4. If a taxpayer suffered a tax loss more than one (1) year, this article shall be applied to the losses in the order in which they have arisen.</p> <p>5. The provisions of this Article shall be allowable only to the taxpayer which created the loss. If the business has an ownership change of more than fifty percent 50% or if a personal business enterprise is changed in any other form of</p>	<p>1. Poreski gubitak je negativna razlika između dozvoljenih dohodaka i rashoda, utvrđenih ovim zakonom.</p> <p>2. Visina poreskog gubitka utvrđena ovim članom prenosi se na četiri (4) uzastopne poreske godine i dostupna je kao odbitak za bilo koji dohodak za te godine.</p> <p>3. Preneseni iznos koji se uzima u obzir za bilo koji poreski period nakon godina poreskog gubitka je ukupan iznos gubitka smanjen za iznos koji je prethodno dozvoljen kao odbitak.</p> <p>4. Ako poreski obveznik ima poreske gubitke više od jedne (1) godine, ovaj član se odnosi na gubitke nastale po redu.</p> <p>5. Odredbe ovog člana dozvoljene su samo za poreskog obveznika koji je stvorio gubitak. Ako se u biznisu promeni vlasništvo više od pedeset procenata (50%) ili ako se lično preduzeće promeni u drugi</p>

<p>ndonjë formë tjetër biznesi (entitet juridik, ortakëri apo të ngjashme.) humbja e bartur nuk lejohet.</p> <p>6. Ministri nxjerr akt nënligjor për të rregulluar dispozitat e bartjes së humbjes që lidhen me ndryshimin e llojit të organizatës biznese apo ndryshimit të pronësisë, si dhe çdo dispozitë tjetër të bartjes së humbjes të nevojshëm për zbatimin e këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 28 Shpenzimet e qirasë</p> <p>Nëse një tatimpagues, ndryshe nga një tatimpagues i angazhuar në afarizëm për dhënie me qira të pasurisë së luajtshme apo të paluajtshme, zgjedh të mos mbajë regjistrime të shpenzimeve aktuale të paguara apo të lindura në aktivitetin e qirasë, tatimpaguesit të tillë i lejohet një zbritje nga të ardhurat bruto nga qiraja në një shumë të barabartë me dhjetë për qind (10%) të qirave të pranuar me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të riparimit, arkëtimit të pagesave dhe të shpenzimeve tjera të paguara apo të krijuara gjatë realizimit të qirasë.</p>	<p>business (legal entity, partnership, or similiar) the loss carried forward shall no longer be allowed.</p> <p>6. The Minister may issue a sub-legal act in order to regulate the provisions for carrying forward the loss related to the changing the type of business organization or changing ownership, as well as every other necessary provision of carrying forward loss for the implementation of this Article.</p> <p style="text-align: center;">Article 28 Rent Expenses</p> <p>If a taxpayer, other than a taxpayer engaged in business of renting movable or immovable property, opts to not maintain records of actual expenses incurred in the renting activity, such taxpayer shall be allowed a deduction from gross income from rent in an amount equal to ten percent (10%) of the rents received in order to cover the costs of repairs, collection charges and other expenses paid or incurred when generating the rent.</p>	<p>poslovni oblik (pravno lice, partnerstvo ili slično), preneseni gubitak nije dozvoljen.</p> <p>6. Ministar donosi podzakonski akt kojim se uređuju odredbe za prenos gubitaka koji se odnose na promenu vrste poslovne organizacije ili promene vlasništva, kao i svaku drugu odredbu prenosa gubitka potrebnog za primenu ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">Član 28 Troškovi zakupa</p> <p>Ako poreski obveznik, za razliku od poreskog obveznika koji se bavi poslovima zakupa pokretne ili nepokretne imovine, bira da ne vodi evidenciju o stvarnim troškovima koji su plaćeni ili nastali u vezi sa zakupom, takvom poreskom obvezniku je dozvoljen popust od bruto dohodaka od zakupa u iznosu od deset procenata (10%) iznajmljenih zakupa kako bi se pokrili troškovi popravki, naplata plaćanja i ostali troškovi koji su plaćeni ili nastali tokom zakupa.</p>
--	---	--

<p align="center">Neni 29 Zbritjet e lejuara për aktivitetet me interes publik</p>	<p align="center">Article 29 The deduction allowed for public interest activities</p>	<p align="center">Član 29 Dozvoljeni odbitci za aktivnosti od javnog interesa</p>
